



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.418/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Arsim Hamzaj dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj, me seli në Skenderaj, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit të komunës së Skenderaj për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 10.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtuar nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj, me seli në Skenderaj, ZL.Anr.418/2025, e datës 07.11.2025, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit të komunës së Skenderaj për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 07.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.418/2025, përmes postes të dorëzuar më datë 05.11.2025, nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj, me seli në Skenderaj, në të cilën thekson se duke pasur parasysh mbajtjen e zgjedhjeve në vendin tone të mbajtura me 12.10.2025 si dhe pas mbajtjes dhe certifikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së me datë 03.11.2025, si dhe sipas atij rezultati të certifikimit Iniciativa Qytetare për Skenderaj, kandidatet për asamble komunale nga ky subjekt janë renditur sipas numrit të votave të marrura nga ky subjekt. Tutje në ankese theksohet se ne si Iniciativë Qytetare për Skenderaj, në përgjithësi kemi marrë në numër të votave e shprehur në përqindje si subjekt politik ndërsa ne për gjithë këto vota sipas vendimit të KQZ, kemi arritur vetëm një kandidat për asamble komunale si është e mundur një gjë e tillë se si një subjekt tjetër politik Vetëvendosje të këtë përqindje thuja të njëjte e të kenë ata 3 anëtarë për asamble komunale e ndërsa ne vetëm një, si është e mundur qe subjekti tjetër politik AAK, ka arritur qe vetëm me 300 vota të jenë me një përfaqësues në kuvendin komunal e ne jo me shume se vetëm një kur kemi kaluar me shume se 1100 vote si subjekt politik. Po ashtu në ankese theksohet se ne si subjekt Politik si Iniciativë Qytetare jemi duke garuar për here të pare në këto zgjedhje dhe për të njëjtën çështje mendojmë se na është bërë e pa drejtë vlerësimi i kandidatëve për asamble komunale andaj duam dhe dëshirojmë të sqarojmë të drejtën tone e cila neve na takon.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se ndarja e ulëseve në Kuvendin e Komunës së Skenderajt është bërë në pajtim me Nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, i cili përcakton se shpërndarja e vendeve bëhet përmes metodës së pjesëtimit proporcional, duke pjesëtuar numrin e votave të vlefshme të secilit subjekt politik me vargun tek të numrave 1, 3, 5, 7, 9 e kështu me radhë, deri në sigurimin e numrit të koeficienteve të nevojshëm për ndarjen e të gjitha ulëseve. Pas krijimit të koeficienteve, ata renditen në

mënyrë zbritëse dhe ulëset ndahen duke filluar nga koeficienti më i lartë, derisa të plotësohet numri i përgjithshëm prej 27 vendeve në Kuvendin Komunal. Në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka marrë 11,919 vota (80,04%), ka siguruar shumicën e koeficienteve më të lartë dhe rrjedhimisht ka fituar 21 ulëse. Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 1,392 vota (9.35%), ka fituar 3 ulëse, ndërsa NISMA me 489 vota (3.28%), Iniciativa Qytetare për Skenderaj me 432 vota (2,90%) dhe AAK me 336 vota (2.26%) kanë fituar nga 1 ulëse secila, pasi koeficientet e tyre të parë renditen më poshtë në listën e përgjithshme të pjesëtimit. Kjo shpërndarje është rezultat i zbatimit të formulës të përcaktuar në nenin e sipërpërmendur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë dhe provave të bashkangjitura në përgjigje, vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj, janë të pabazuara. Paneli vlerëson se pretendimet ankimore të subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj, se megjithëse ka marrë një numër të konsiderueshëm votash të shprehura në përqindje të ngjashme me subjektet e tjera, ka fituar vetëm një ulëse në Kuvendin Komunal, ndërsa subjektet e tjera me përqindje të ngjashme, si Lëvizja Vetëvendosje, kanë fituar më shumë përfaqësues. Paneli vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi ndarja e ulëseve në Kuvendin e Komunës së Skenderajt është bërë në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, i cili përcakton se shpërndarja e vendeve bëhet përmes metodës së pjesëtimit proporcional, duke pjesëtuar numrin e votave të vlefshme të secilit subjekt politik me vargun taktë numrave 1, 3, 5, 7, 9 e kështu me radhë, deri në sigurimin e numrit të koeficienteve të nevojshëm për ndarjen e të gjitha ulëseve. Pas krijimit të koeficienteve, ata renditen në mënyrë zbritëse dhe ulëset ndahen duke filluar nga koeficienti më i lartë, derisa të plotësohet numri i përgjithshëm prej 27 vendeve në Kuvendin Komunal. Në rastin konkret në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka marrë 11,919 vota (80,04%), ka siguruar shumicën e koeficienteve më të lartë dhe rrjedhimisht ka fituar 21 ulëse, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 1,392 vota (9.35%), ka fituar 3 ulëse, NISMA me 489 vota (3.28%), Iniciativa Qytetare për Skenderaj me 432 vota (2,90%) dhe AAK me 336 vota (2.26%) kanë fituar nga 1 ulëse secila.

Iniciativa Qytetare për Skenderaj, AAK dhe Nisma kanë fituar nga një ulëse secila, në përputhje me metodën e shpërndarjes së ulëseve dhe numrin e votave të fituara. Prandaj, duke u bazuar në pasqyrën për vendet e fituara në kuvendin e komunës së Skenderaj të lëshuar nga KQZ paneli vëren se për 27 vendet në Kuvendin e Komunës së Skenderaj, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 1392 vota, në përqindje prej 9.35%, ndërsa Iniciativa Qytetare për Skenderaj ka fituar 432 vota, në përqindje prej 2.90%. Mbi këtë bazë Paneli vëren se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, pasi Iniciativa Qytetare për Skenderaj, në bazë të votave të fituara, me të drejtë është vlerësuar nga KQZ se ka siguruar vetëm një ulëse, njësoj si subjektet politike NISMA që i ka fituar 489 vota, AAK që ka fituar 336 vota.

Në këtë kuptim paneli vlerëson se KQZ në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka zbatuar nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, i cili përcakton se *“8.1 Vendet për çdo Kuvend të Komunës ndahen si vijon: a) numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik në komunë pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë, derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të përgjithshëm të vendeve, që do t'i ndahen atij Kuvendi i komunës; b) koeficientet që rezultojnë nga vargu i pjesëtimit rregullohen në renditje zbritëse. Vendet iu ndahen subjekteve politike sipas koeficienteve në mënyrë që vendi i parë i takon subjektit që e ka koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit që e ka koeficientin e radhës më të madh, e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në Kuvendin Komunal përkatës. c) nëse një subjekt politik i ndahen vende që janë baraz me numrin e kandidatëve në listën e tij dhe ka ende vende për të ndarë, atëherë pjesa e mbetur e koeficientit të atij subjekti nuk merret parasysh gjatë ndarjes së vendeve të mbetura. Koeficientet pasues me renditje zbritëse përdoren derisa të ndahen të gjitha vendet në Kuvendin e Komunës përkatës; d) nëse ndodh barazimi për shkak se dy ose*

më shumë koeficiente janë të njëjtë, vendi ndahet me hedhje të shortit nga kryesuesi i KQZ-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike në fjalë. 8.2 Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat. 8.3 Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. 8.4 Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”

Prandaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, ankuesi nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet Lokale apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lart, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.418/2025 datë 10.11.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.